

Bazuar në nenin 35, paragrafin 1.1 të Ligjit nr. 03/L-209 mbi Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.77 / 16 gusht 2010) dhe nenet 17 paragrafi 2 dhe 85 të Ligjit nr. 04/L-093 për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.11 / 11 maj 2012), Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës në mbledhjet e mbajtur më 31 tetor 2013, miratoi si në vijim:

**RREGULLORE  
PËR DEPOZITËN E KUIVALENTE ME KAPITALIN  
PËR DEGËT E BANKAVE TË HUAJA**

**Neni 1  
Qëllimi dhe fushëveprimi**

1. Qëllimi i kësaj rregulloreje është përcaktimi i shumës së depozitës ekuivalente me kapitalin për degët e bankave të huaja, të kërkuar me paragrafin 2 të nenit 17 të Ligjit nr.04/L-093 për bankat, institucionet mikrofinanciare dhe institucionet financiare jobankare (në vijim: *Ligji për bankat*), dhe përcaktimi i kriterëve për investimin e saj.
2. Kjo rregullore aplikohet për degët e bankave të huaja të licencuara nga BQK-ja për të operuar në Republikën e Kosovës.

**Neni 2  
Përkufizimet**

1. Të gjitha termet e përdorura në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termet e përdorura në nenin 3 të Ligjit për bankat, dhe / ose me përkufizimet si në vijim për qëllimin e kësaj rregulloreje:
  - a) *Depozitë Ekuivalente me Kapitalin* (në vijim: *DEK*) - është pjesa e kapitalit fillestar minimal të dhënë dhe të paguar në para nga banka-mëmë, për ushtrimin e veprimtarisë nga dega e saj në Republikën e Kosovës, të cilën dega është e obliguar ta investojë në mjete që janë në pajtim me kushtet dhe kërkesat e përcaktuara me këtë rregullore;
  - b) *Degë e një Banke të Huaj* (në vijim: *Dega*) është subjekt i organizuar dhe i licencuar nga BQK-ja, për të ushtruar veprimtari bankare në Republikën e Kosovës, por banka-mëmë e të cilës ka selinë e vet kryesore dhe mban licencë për të ushtruar veprimtari bankare në një juridiksion tjetër jashtë Republikës së Kosovës;
  - c) *Banka-mëmë* - është banka e huaj e licencuar për të ushtruar veprimtari bankare nga autoriteti përgjegjës i vendit të huaj, të cilës i është dhënë e drejta nga BQK-ja për të hapur një degë të saj në Republikën e Kosovës.

### **Neni 3**

#### **Shuma minimale e DEK**

1. Çdo banke të huaj që vendos të themelojë një degë në Republikën e Kosovës e jo një subjekt të varur, i kërkohet me këtë rregullore, që të deponojë në BQK në emër të kapitalit fillestar, një shumë prej shtatë (7) milionë Euro si DEK, për themelimin e degës së saj, kërkesë kjo që nuk mund të anashkalohej për asnjë arsye.

2. Shuma fillestare e kërkuar në emër të DEK-ut, është e njëjtë me atë të kapitalit minimal të kërkuar për bankat apo subjektet e varura dhe ka të njëjtin funksion me atë të kapitalit për një bankë apo subjekt të varur. Megjithatë, kjo shumë mund të rritet varësisht si e vlerëson të nevojshme BQK-ja në të ardhmen, duke u bazuar në vlerësimin e rreziqeve bankare. Niveli i kërkuar i DEK-ut sipas paragrafit 1 të këtij neni, duhet të mirëmbahet në çdo kohë.

3. Objektivi i BQK-së është që DEK-u i kërkuar për çdo degë të bankave të huaja, të sigurojë një rezervë të mjaftueshme të likuiditetit për rastet kur fondet e këtilla mund të jenë të nevojshme gjatë operimit të degës.

### **Neni 4**

#### **Funksionet e investimit të DEK**

1. Investimet e DEK-ut duhet të sigurojnë, në veçanti në rastet e likuidimit:

- a) Një burim të fondeve likuide në rast nevoje;
- b) Një burim të fondeve me rrezik të ulët për kthim të shpejt në rast nevoje;
- c) Një mbrojtje për depozituesit e degëve dhe për kryerjen e obligimeve ndaj kreditorëve tjerë në rast nevoje.

### **Neni 5**

#### **Investimi i DEK**

1. Dega e një banke të huaj, pas pranimin të licencës për të ushtruar veprimtari bankare nga ana e BQK-së, mund të investojë DEK-un në një apo më shumë mjete si në vijim:

- a) Të depozitojë atë në Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës; dhe
- b) Në letra me vlerë të emetuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës;

2. Përveç siç specifikohet në paragrafin 1 të këtij neni, BQK-ja sipas vlerësimit të saj, mund të lejojë me anë të aprovimit me shkrim investimin e DEK-ut edhe në institucione të tjera jashtë Kosovës dhe me një reiting të caktuar dhe të njohur ndërkombëtarisht në një nga bankat e vendeve të unionit evropian.

3. Dega nuk lejohet në asnjë rast të investojë DEK-un pranë bankës mëmë.

4. Investimi i DEK-ut duhet të jetë në kujdestari të BQK-së dhe nuk mund të tërhiqet pa aprovimin paraprak me shkrim të BQK-së.

**Neni 6**  
**Mbikëqyrja dhe raportimi**

1. Për implementimin e kërkesave dhe obligimeve të përcaktuara me këtë rregullore, BQK-ja në vazhdimësi vlerëson shumën e DEK-ut, minimumi i të cilës është përcaktuar me paragrafin 1 të nenit 3 të kësaj rregulloreje të investuar në pajtueshmëri me kërkesat e përcaktuara me nenin 5 të kësaj rregulloreje;

2. Degëve të bankave të huaja iu kërkohet të raportojnë në BQK, jo më vonë se pesëmbëdhjetë (15) ditë pas çdo tremujori, formën mbi DEK-un e paraqitur në aneksin e rregullores për raportimin e bankave në BQK.

**Neni 7**  
**Zbatimi, masat përmirësuese dhe dënimet civile**

Çdo shkelje e kësaj rregulloreje do të jetë subjekt i masave përmirësuese dhe dënimeve civile, të përcaktuara në nenet 58, 59 dhe 82 të Ligjit për banka.

**Neni 8**  
**Shfuqizimi**

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, shfuqizohet Rregullorja për depozitën ekuivalente me kapitalin për degët e bankave të huaja e datës 9 nëntor 2012.

**Neni 10**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn në fuqi me datën 15 nëntor 2013.

Kryetari i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës

---

Mejdi Bektashi